



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 424 Prot.

Tiranë, më 6/3 /2017

VENDIM

Nr. 46, datë 6/3 /2017

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi, Qendra "Res Publica", përfaqësuar nga Av. \_\_\_\_\_, në cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim quajtur "Komisioneri") ankimin nr. 1275/3 Prot., datë 14.12.2016, kundër Autoritetit Publik/Prokuroria e Përgjithshme/Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda me objekt "*Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare*".

Ankuesi ka depozituar pranë Autoritetit Publik kërkesën për informacion si më poshtë:

1. *Të dhëna për arsimin, kualifikimet dhe pagat e funksionarëve, të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë sipas ligjit.*
2. *Kopje të buxhetit për vitin 2015-2016.*
3. *Kopje të planit të shpenzimeve për vitin financiar në vijim dhe për vitet financiare 2014-2016;*
4. *Kopje të raporteve të auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose nga subjekte të tjera;*
5. *Informacion për procedurat e prokurimit apo procedurat konkurruese të koncesionit/partneritetit publik privat, përkatësisht, sipas parashikimeve të ligjit nr.9643, datë 20.12.2006, "Për prokurimin publik", dhe të ligjit nr.125/2013, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", që kryhen për llogari të autoritetit publik, duke përfshirë: listën e kontratave të lidhura; shumën e kontraktuar; palët kontraktuese dhe përshkrimin e shërbimeve apo mallrave të kontraktuara; informacionin për zbatimin dhe monitorimin e kontratave, si dhe udhëzues e politika të ndryshme.*

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda i është përgjigjur kërkuarit me shkresën nr. 7611/1 Prot datë 31.10.2016 duke i vënë në dispozicion informacion të pjesëshëm (Rregulloren e Brendshme të këtij institucioni) si dhe duke i rekomanduar që t'i drejtohet Prokurorisë së Përgjithshme si autoriteti kompetent për dhënien e informacionit.

Ankuesi ka paraqitur ankimin nr. 1275 datë 14.11.2016 pranë Komisionerit i cili, në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, me shkresën nr.1275/1 Prot, datë 16.11.2016, si hap paraprak përpara marrjes së vendimit, i ka kërkuar Autoritetit Publik/Prokurorisë së Përgjithshme përmbushjen e detyrimit për dhënie informacioni brenda datës 23.11.2016.

Autoriteti Publik/Prokuroria e Përgjithshme i është përgjigjur kërkuarit me shkresën nr. 1716/1 Prot datë 23.11.2016 ku i ka dhënë një informacion jo të plotë kërkesave të këtij të fundit.

Konkretisht ankuesi pretendon se informacioni i mbledhur sipas orientimeve të dhëna nga Autoriteti Publik nuk përfshin zëra që janë specifike për prokuroritë e rretheve dhe ato të posaçme siç është ajo për krime të rënda. Për këtë arsye ankuesi pretendon se është cënuar në të drejtën për informim, dhe ka depozituar sërish ankim pranë Komisionerit.

Pas shqyrtimit të ankimit rezulton se, informacioni i kërkuar nga ankuesi ka të bëjë me Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda ndërkohë që në faqen zyrtare është publikuar informacion që lidhet me Prokurorinë e Përgjithshme.

Megjithëse insitucioni i Prokurorisë funksionon në mënyrë të centralizuar, vlerësojmë se informacioni i kërkuar nuk mund t'i refuzohet kërkuarit, për më tepër në bazë të nenit 7 të Ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" informacioni i kërkuar nga Qendra "Res Publica" bën pjesë në atë kategori informacioni që duhet të bëhet publik pa kërkesë.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e Qendrës "Res Publica" kundër Autoritetit Publik/Prokurorisë së Përgjithshme/Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Komisioneri vlerëson se ankimi është i bazuar në ligj dhe si i tillë ai duhet pranuar.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e Qendrës "Res Publica" ndaj Autoritetit Publik/Prokurorisë së Përgjithshme/Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Komisioneri vlerëson se ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

### PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative",

### V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës së Qendrës "Res Publica", Nr.1275/3 Prot., datë 14.12.2016, ndaj Autoritetit Publik/Prokuroria e Përgjithshme/Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare".
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik/Prokuroria e Përgjithshme/Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, për vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar, brenda datës 13. 3.2017.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.
4. Ky vendim u dha sot me datë 6. 3.2017.

